



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
GJYKATA E REJTIT GJYQËSOR  
LUSHNJË

Nr. 113/721 Akti

Lushnje, më 23.09.2016

LËNDA: DËRGIM VENDIMI

DREJTUAR: QENDRES KOMBËTARE TE REGJISTRIMIT

TIRANE

Për të bërë veprimet përkatëse ju dërgojme vendimin e kësaj gjykate Nr. 610 (64-2016-1404), date 06.09.2016, që ju përket palëve:

- Paditesa** -- Anëtarë të shoqërisë
- I paditur** -- Shoqëria tregtare "Transudhëtare" Shpk Lushnje.
- Objekti** -- Shfuqizimi Vendimi dt. 10.09.2009 të Asamblesë së ortakëve të Shoqërisë "Transudhëtare" Shpk me ane të së cilit janë miratuar tjetërsimet dhe shitblerjet e kuotave të ortakëve paditës etj .





REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
GJYKATA E RRETHIT GJYQËSOR  
LUSHNJE



Nr 113/721 (847) Akti  
Dt. Regj 25.06.2015

Nr. 610 (64-2016- 1404) Vendimi  
Dt. Shpalljes 06.09.2016

VENDIM  
« NË EMËR TË REPUBLIKËS »

Gjykata e Rrethit Gjyqësor Lushnje e përbërë nga:

**BRIKENA UKPERAJ-LUBONJA ----- GJYQTARE**

Asistuar prej sekretares gjyqësore **Matilda Çela**, sot në datë 06.09.2016, përfundoi shqyrtimin gjyqësor publik të çështjes civile me Nr. 113/721 (847) Akti që i përket :

**PADITES :**

1. **Adrian Mbole** i biri i Hakiut dhe i Shemshies, dtl. 12.12.1958, lindur në Tepelenë dhe banues në Lushnje, Lagja "Xhevdet Nepravishta" me cilësinë e ortakut në shoqërinë "Transudhëtare" shpk, përfaqësuar në gjykim nga **av. Kozma Jano**, sipas tagrave të përfaqësimit të dhëna me prokurën e posaçme Nr. 2259 Rep 1216/2 Kol dt. 12.11.2015.

2. **Luftar Zonja**, i biri i Mahmutit dhe i Nerkizes, i dtl. 07.11.1944, lindur Kamçisht dhe banues ne Lushnje, lagja "Xhevdet Nepravishta", me cilësinë e ortakut në shoqërinë "Transudhëtare" shpk, përfaqësuar në gjykim nga **av. Kozma Jano**, sipas tagrave të përfaqësimit të dhëna me prokurën e posaçme Nr. 2259 Rep 1216/2 Kol dt. 12.11.2015.

3. **Gëzim Muhametaj**, i biri i Skënderit dhe i Aishes, dtl.26.12.1956, lindur e banues ne Lushnje, Lagja "Gafurr Muço", me cilësinë e ortakut në shoqërinë "Transudhëtare" shpk, përfaqësuar në gjykim nga **av. Kozma Jano**, sipas tagrave të përfaqësimit të dhëna me prokurën e posaçme Nr. 2259 Rep 1216/2 Kol dt. 12.11.2015.

4. **Pllumb Çala**, i biri i Vathit dhe i Sybes, dtl. 02.10.1956, lindur e banues ne Lushnje, Lagja "Gafurr Muço", me cilësinë e ortakut në shoqërinë "Transudhëtare" shpk, përfaqësuar në gjykim nga **av. Kozma Jano**, sipas tagrave të përfaqësimit të dhëna me prokurën e posaçme Nr. 2259 Rep 1216/2 Kol dt. 12.11.2015.

5. **Arben Manko**, i biri i Veliut dhe Merushes, dtl. 29.01.1966, lindur e banues ne Lushnje, Lagja "Gafurr Muço", me cilësinë e ortakut në shoqërinë "Transudhëtare" shpk, përfaqësuar në gjykim nga **av. Kozma Jano**, sipas tagrave të

përfaqësimit të dhëna me prokurën e posaçme Nr. 2259 Rep 1216/2 Kol dt. 12.11.2015.

**6. Bashkim Taullau**, i biri i Hajdarit dhe i Lirisë, dtl. 20.12.1966, lindur e banues ne Lushnje, Lagja "Skënder Libohova", me cilësinë e ortakut në shoqërinë "**Transudhëtare**" shpk, përfaqësuar në gjykim nga **av. Kozma Jano**, sipas tagrave të përfaqësimit të dhëna me prokurën e posaçme Nr. 2259 Rep 1216/2 Kol dt. 12.11.2015.

**7. Albert Koço**, i Jovanit dhe i Uranise, dtl.16.03.1964, lindur dhe banues ne Lushnje, Lagja "Skender Libohova", me cilësinë e ortakut në shoqërinë "**Transudhëtare**" shpk, përfaqësuar në gjykim nga **av. Kozma Jano**, sipas tagrave të përfaqësimit të dhëna me prokurën e posaçme Nr. 2259 Rep 1216/2 Kol dt. 12.11.2015.

**8. Polikseni Cili**, e bija e Llazit dhe e Fanijes, e dtl. 27.11.1955, lindur ne fshatin Pirrë dhe banuese në Lushnje, Lagja "Kongresi", me cilësinë e ortakut në shoqërinë "**Transudhëtare**" shpk, përfaqësuar në gjykim nga **av. Kozma Jano**, sipas tagrave të përfaqësimit të dhëna me prokurën e posaçme Nr. 2259 Rep 1216/2 Kol dt. 12.11.2015.

**9. Konstandin Blido**, i biri i Sotirit dhe i Kristines, i dtl. 02.11.1964, lindur ne Berat dhe banues ne Lushnje, lagja "Skender Libohova", me cilesine e ortakut në shoqërinë "**Transudhëtare**" shpk, **Lushnje**, përfaqësuar në gjykim nga **av. Kozma Jano**, sipas tagrave të përfaqësimit të dhëna me prokurën e posaçme Nr. 1655 Rep 896/1 Kol dt. 02.09.2015.

**10. Verjon Zonja**, i biri i Luftarit dhe i Floreshes, i dtl. 02.05.1970, lindur dhe banues ne Lushnje, lagja "Xhevdet Nepravishta", me cilesine e ortakut në shoqërinë "**Transudhëtare**" shpk, **Lushnje**, përfaqësuar në gjykim nga **av. Kozma Jano**, sipas tagrave të përfaqësimit të dhëna me prokurën e posaçme Nr. 2259 Rep 1216/2 Kol dt. 12.11.2015.

#### **E PADITUR :**

**Shoqëria tregtare "Transudhëtare" shpk**, me qendër të ushtrimit të veprimtarisë tek Ish/Parku i Udhëtareve Lushnje, me përfaqësues ligjor njëkohësisht administrator të saj, z. **Edmond Sulo**

#### **OBJEKTI :**

1. Shfuqizimin e vendimit dt. 10.09.2009 të Asamblesë së ortakëve të Shoqërisë "Transudhëtare" Sh.p.k me ane te së cilit janë miratuar tjetërsimet dhe shitblerjet e kuotave të ortakëve paditës.

2. Shfuqizimin e vendimit dt. 16.11.2009 të Asamblesë së ortakëve të Shoqërisë "Transudhëtare" Sh.p.k me ane të së cilit është miratuar zvogëlimi i kapitalit themeltar të shoqërisë

dhe numrit të kuotave të Shoqërisë nga 1349 kuota ne 1325 kuota.

3. Ndryshimin e të dhënave në regjistrin tregtar përsa i përket pjesëve zotëruese të secilit nga 10/paditësit në kapitalin themeltar të Shoqërisë.

#### **BAZA LIGJORE :**

Nenet 32 i K.Pr.Civile; Ligji Nr. 9901 dt. 14.04.2008 "Per tregtarët e shoqëritë tregtare", nenet 68 - 105 të tij, neni 21 i Statutit të Shoqërisë "Transudhëtare" shpk.

Në bisedimet përfundimtare :

**Pala paditëse** kërkoi pranimin e padisë sipas objektit të saj, anulimin e dy vendimeve të Asamblesë së Shoqërisë "Transudhëtare" Sh.p.k Lushnje dt.11.09.2009 dhe 16.11.2009, për shkak të pavlefshmërisë së tyre e për pasojë ndryshimin e të dhënave të regjistrin tregtar për 10/ortakët paditës nëpërmjet pasqyrimin të numrit të kuotave sipas aktit të ekspertimit kontabël e vlerësues të kuotave të ekspertes Eleda Dhima.

**Pala e paditur :** Pranimin pjesërisht të padisë. Shfuqizimin e vendimeve të Asamblesë së Shoqërisë "Transudhëtare" shpk dt. 10.09.2009 dhe 16.11.2009 dhe kthimin e Shoqërisë në gjendjen e regjistrimit fillestar përpara këtyre vendimeve.

Gjykata pasi dëgjoi palët dhe çmoi në tërësi provat e debatuarat gjatë hetimit gjyqësor;

#### **VEREN**

Se 10/paditësit ortakë në Shoqërinë tregtare "Transudhëtare" shpk i janë drejtuar kësaj gjykate me padinë me palë ndërgjyqëse, objekt e bazë ligjore si më lart.

Natyrë e marrëdhënies juridike objekt konflikti në rastin konkret i përket juridiksionit gjyqësor, në kushtet kur ekziston një mosmarrëveshje midis shoqërisë dhe 10 (dhjetë) prej ortakëve të saj, lidhur me vendimmarrjet e asamblesë së kësaj Shoqërie për miratimin e transferimit të kuotave si dhe atij për zvogëlimin e kapitalit themeltar të shoqërisë, çka ka sjellë një pasqyrim jo real të numrit real të kuotave që secili prej tyre është titullar, situatë për korrigjimin e së cilës nuk është bërë e mundur thirrja e asamblesë së ortakëve (anulimi i kuotave te ortakeve që i zotërojnë në kundërshtim me ligjin). Për këtë shkak dhe në zbatim të neneve 36, 334-336 të K.Pr.Civile, neni 4 të ligjit Nr. 9901 dt. 14.04.2008 "Për shoqëritë tregtare", të ndryshuar, e dispozitave të Statutit të Shoqërisë, kompetenca lëndore e tokësore në shqyrtimin e kësaj padie i përket Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lushnje ku ka qendrën e ushtrimit të veprimtarisë pala e paditur.

Lidhur me legjitimitimin procedural civil të secilit nga 10/ortakët paditës për vënien në lëvizje të Gjykatës në një rast të tillë edhe pse Ligji Nr. 9901 dt. 14.04.2008, i cili veç dispozitave materiale ka në përmbajtje të tij edhe dispozita me karakter procedural, nuk përmban shprehimisht rastet se kur ortaku mund të kundërshtojë vendimin e asamblesë së Shoqërisë, indirekt i jep të drejtë çdo ortaku pavarësisht nga shtrirja e të drejtës së tij mbi kuotat në Shoqëri, t' i drejtohet Gjykatës kur pengohet në ushtrimin e së drejtave që rrjedhin nga zotërimi i kuotës. Kjo e drejtë e ortakut që nuk mund të kufizohet me Statutin e shoqërisë parashikohet nga neni 93 dhe 94 i Ligjit të Posaçëm ku parashikohet se :

Neni 93 i Ligjit 9901 parashikon : " Ortaku, që pengohet të ushtrojë të drejtat që i rrjedhin nga zotërimi i kuotës së shoqërisë, ka të drejtë t'i kërkojë gjykatës të urdhërojë ndalimin e cenimit apo shpërblimin e dëmit të shkaktuar, si pasojë e cenimit të këtyre të drejtave. Kjo e drejtë parashkruhet brenda 3 vjetëve nga çasti i cenimit".

Neni 94 parashikon : "Janë të pavlefshme dispozitat e statutit, që kufizojnë ose përjashtojnë ndonjë nga të drejtat e ortakëve ose të kreditorëve, sipas përcaktimeve të bëra në nenet 91, 92 e 93 të këtij ligji, si dhe dispozitat, që parashikojnë kufizime të përgjithshme të veprimeve të përcaktuara në këto nene. 2. Vendimet e asamblesë së përgjithshme nuk mund të cenojnë të drejtën e ortakëve ose të kreditorëve për të kryer veprimet e parashikuara në nenet 91, 92 e 93 të këtij ligji".

Bazuar në të drejtën materiale të parashikuar ne dispozitat e mësipërme si dhe në gjendjen e faktit që do të analizohet me poshtë, (shkaku i padisë), 10/ortakët paditës fillimisht kërkonin me anë të padisë së ngritur ndaj shoqërisë që ajo te detyrohej të ndryshonte të dhënat e publikuara në regjistrin tregtar lidhur me kuotat që ata zotëronin në Shoqërinë "Transudhëtare" shpk, pasi ky publikim nuk ishte real, çka i cënonte në të drejtat që ata zotëronin për shkak të kuotës në Shoqëri, cënime qe fillonin me të drejtën e votës si dhe pjesëmarrjen në fitimet e humbjet e Shoqërisë. Gjatë shqyrtimit gjyqësor bazuar në nenin 185/1 i K.Pr.Civile pas debatimit te aktit te ekspertimit për te cilin u disponua nga Gjykata, prej 10/ortakëve paditës u kërkuua shtimi i objektit të padisë edhe me kërkimin e anulimit të dy vendimeve të Asamblesë së Shoqërisë për miratimin e transferimit të kuotave si dhe zvogëlimin e kapitalit themeltar, me pretendimin se përbënin akte të pavlefshme, për shkak të të cilave ata ishin cënuar në të drejtat që rridhnin nga zotërimi i kuotës, i pasuar nga regjistrime të pavlefshme në QKR (sot Qendra Kombëtare e Biznesit). Me vendim të ndërmjetëm Gjykata pranoi kërkesën për shtim të objektit te padisë si e drejte ne disponim të palës paditëse e qe ushtrohej prej saj pa ndryshuar shkakun ligjor te padisë.

#### *Gjate gjykimit të çështjes rezultuan te provuara faktet e mëposhtme :*

1. Shoqëria tregtare "Transudhëtare" shpk, ka fituar personalitetin juridik pas regjistrimit si person juridik në dt. 28.02.1995 (vendim i Gj.Rr.Gj Tiranë për regjistrimin si person juridik), e krijuar si shoqëri me përgjegjësi të kufizuar në mbështetje të Ligjit Nr. 7638 dt. 19.11.1992 "Për Shoqëritë tregtare" duke rregulluar marrëdhëniet dhe organizimin e saj sipas këtij ligji. Shoqëria fillimisht ka pasur 61 ortakë me administrator shtetasin Gëzim Troka. Kjo shoqëri ka për objekt veprimtarie te saj : "Transportin e udhëtareve e punonjësve brenda e jashtë vendit, riparim mjetesh, kolaudim periodik i mjeteve te veta, parkim i mjeteve private e shtetërore, kurse kualifikimi për shofer, tregtim karburantesh dhe vajrash lubrifikantë.....etj". Nga 10/ortakët paditës vetëm 4 prej tyre kanë qenë ortakë themelues të kësaj Shoqërie, e cila kishte kapital themeltar 13 490 000 lekë, të ndarë në 1349 kuota me vlerë 10 000 secila. Konkretisht nga 10/paditësit kanë qenë ortakë themelues nga 61 gjithsej, vetëm : Adrian Mbole me 12 kuota; Luftëtar Zonja me 42 kuota; Pllumb Cala me 12 kuota dhe Albert Koço me 12 kuota.

2. Gjatë kohëzgjatjes së Shoqërisë disa prej ortakëve të saj kanë shitur kuotat duke u zëvendësuar nga ortakë të tjerë në Shoqëri. Ky transferim kuotash është miratuar me vendimin e dt. 10.09.2009 të Asamblesë së ortakëve të Shoqërisë, vendim i zbardhur në dt. 11.09.2009, ku veç të tjerash në lidhje me ortakët paditës është miratuar :

- Shitja e 4 kuotave nga ortaku Skënder Rakipi tek ortaku i ri **Arben Manko**. Veç këtyre kuotave ky i fundit kishte blerë ne dt. 15.04.1997 edhe kuotat e shtetasit Gëzim Halili, të cilat ne kontratë referohen si vlerë kapitali dhe jo si numër

kuotash, por një transferim i tille edhe pse është depozituar ne regjistrin tregtar nuk rezulton i miratuar nga Asambleja ;

- Shitja e 10 kuotave nga ortaku Petraq Cuko tek ortaku i ri **Konstandin Blido**, ndërkohë që ky miratim është dhënë pas 7/vitesh se të ishte bërë transaksioni, i cili nuk rezulton të jetë bërë me kontratë noteriale por për shitjen e kuotave ish/ortaku Petraq Cuko kishte bërë deklaram para noterit ne dt. 26.09.2002 ku i referohet vlerës se kapitalit qe ai zotëronte në shoqëri dhe jo numrit të kuotave qe ai transferonte tek blerësi Konstandin Blido ;
- Shitja e 10 kuotave nga ortaku Shefit Liçka tek ortaku i ri **Verjon Zonja**, ndërkohë që ky miratim është dhënë pas 7/vitesh se të ishte bërë transaksioni, i cili nuk rezulton të jetë bërë me kontratë noteriale por për shitjen e kuotave ish/ortaku Shefit Liçka kishte bërë deklaram para noterit ne dt. 11.09.2002 ku i referohet vlerës se kapitalit qe ai zoteronte ne shoqëri dhe jo numrit të kuotave qe ai transferonte tek blerësi Verjon Zonja. Në dt. 10.09.2009 kur është bërë mbledhja e asamblesë për miratimin e këtij transferimi ortaku Shefit Liçka, kishte ndërruar jetë, pasi edhe pse rezulton të ketë nënshkruar në listën e ortakëve prezent në mbledhje në fakt ai kishte ndërruar jetë një muaj pas deklaramit të mësipërm para noterit, dt. vdekjes 21.10.2002 (çertifikata e vdekjes e marre si prove ne gjykim).
- Shitja e 10 kuotave nga ortaku Spiro Neço tek ortaku i ri **Gëzim Muhametaj**, ndërkohë që ky miratim është dhënë pas 12/vitesh se të ishte bërë transaksioni, i cili nuk rezulton të jetë bërë me kontratë noteriale por për shitjen e kuotave ish/ortaku Spiro Neço kishte bërë deklaram para noterit ne dt. 29.09.1997 ku i referohet vlerës se kapitalit qe ai zoteronte ne shoqëri dhe jo numrit të kuotave qe ai transferonte tek blerësi Gëzim Muhametaj;
- Shitja e 10 kuotave nga ortaku Sashenka Jaho tek ortaku i ri **Bashkim Taullau**, ndërkohë që ky miratim është dhënë pas 9/vitesh se të ishte bërë transaksioni, i cili nuk rezulton të jetë bërë me kontratë noteriale por për shitjen e kuotave ish/ortakja Sashenka Jaho kishte bërë deklaram para noterit ne dt. 26.09.2002 ku i referohet vlerës se kapitalit qe ajo zoteronte ne shoqëri dhe jo numrit të kuotave qe ai transferonte tek blerësi Bashkim Taullau ;
- Shitja e 1 kuote nga ortaku Asim Xhaferri tek ortaku **Luftar Zonja**, ndërkohë që ky miratim është dhënë pas 12/vitesh se të ishte bërë transaksioni, i cili në kontratën e shitblerjes Nr. 2660 rep 1050 kol dt. 27.11.1995 i referohet vlerës se kapitalit qe ai zoteron ne shoqëri dhe jo numrit të kuotave qe ai transferonte tek blerësit midis te cilëve ishte edhe paditësi Luftar Zonja;
- Shitja e 1 kuote nga ortaku Sotiraq Xhoxhi tek ortaku **Luftar Zonja**, ndërkohë që ky miratim është dhënë pas 9/vitesh se të ishte bërë transaksioni, i cili në kontratën e shitblerjes Nr. 6677 rep 1043 kol dt. 06.11.1998 i referohet vlerës se kapitalit qe ai zoteron ne shoqëri dhe jo numrit të kuotave qe ai transferonte tek blerësit midis te cilëve ishte edhe paditësi Luftar Zonja;

3. Vendimi i Asamblesë së Ortakëve të Shoqërisë "Transudhëtare" Shpk i dt. 10.09.2009 i zbardhur ne dt. 11.09.2009 është regjistruar në QKR në dt. 16.09.2009, ku përveç 10/paditësve ka ndryshuar gjendja e ortakërisë me largime e pranime ortakësh të rinj edhe për

ortakë të tjerë të shoqërisë, për disa nga të cilët ka ndryshuar edhe numri i kuotave i bashkuar me ato të transferuara nga ortakët e tjerë.

4. Në dt. 16.11.2009 Asambleja e Shoqërisë "Transudhëtare" shpk është mbledhur përsëri **për të miratuar transferimin e 10/kuotave nga Pëllumb Tushe tek paditësja Polikseni Cili**, e cila është pranuar si ortakë e re në Shoqëri, pasi kishte blerë këto kuota nga ish/ortaku me kontratën e noteriale të shitblerjes dt. 12.10.2009. Në të njëjtën mbledhje është miratuar zvogëlimi i kapitalit themeltar për shkak të pakësimit me 24 kuota, pasi rezultoni të ishin larguar nga shoqëria 6 ortakë, çka ka sjellë miratimin e pakësimit me 24 kuota te kuotave totale te shoqërisë nga 1349 në 1325 kuota si dhe zvogëlimin e kapitalit themeltar nga 13 490 000 lekë në 13 250 000 lekë. Ky vendim është regjistruar në QKR në dt. 24.02.2010.

5. Me hyrjen në fuqi të Ligjit Nr. 9901 dt. 14.04.2008 "Për tregtarët e shoqëritë tregtare", Shoqëria ka përshtatur organizimin e funksionimin e saj sipas dispozitave të këtij Ligji nëpërmjet miratimit nga Asambleja e Përgjithshme e Shoqërisë e një statuti të ri, i miratuar në dt. **23.03.2012 i regjistruar në QKR në dt. 02.05.2012**. Referuar këtij Statuti të ri, Shoqëria e cila organizohej përsëri si shpk më emërtimin «TRANSUDHETARE», kishte kapital pasuri të luajtshme dhe të paluajtshme në vlerën **13 250 000 lekë, i ndarë në 1325 kuota**, secila me vlerë nominale 10.000 (dhjetë mijë) lekë, kuota të cilat ishin të ndara ne 49 ortakë të kesaj Shoqërie, ashtu siç ishte vendosur gjendja e ortakërisë pas dy vendimeve të dt. 10.09.2009 dhe 16.11.2009 me shtimin e ortakëve të rinj dhe largimin e disa të vjetër, të pasqyruara bashke me sqarimet përkatëse në aktin e ekspertimit te ekspertës kontabël Eleda Dhima, ku për 10/paditësit situata pasqyrohet si ne tabelën e mëposhtme :

Nr	Emer Mbiemer	Totali me lëvizjet		Statuti dt 23.3.2012		Diferenca
		Nr kuota	Vlera	Nr kuota	Vlera	
1	Adrian Mbole	12	120,000	10	100,000	2 kuota më pak se ato të zoteruara si ortak themelues
2	Luftetar Zonja	42	420,000	70	700,000	28 kuota me shume se ato të zoteruara si ortak themelues
3	Gezim Muhametaj	42	420,000	10	100,000	32 kuota me pak se ato të blera
4	Pëllumb Cala	12	120,000	10	100,000	2 kuota me pak se ato të blera
5	Arben Manko	23	230,000	15	150,000	8 kuota me pak se ato



						te blera
6	Bashkim Taullau	12	120,000	10	100,000	2 kuota me pak se ato te blera
7	Albert Koco	12	120,000	10	100,000	2 kuota më pak se ato të zoteruara si ortak themelues
8	Polikseni Cili	10	10,000	10	100,000	Nuk ka diferenca
9	Verjon Zonja	42	420,000	10	100,000	32 kuota me pas se ato te blera
10	Konstandin Blido	12	120,000	10	100,000	2 kuota me pak se ato te blera
	<b>Shuma</b>	<b>219</b>	<b>2,100,000</b>	<b>165</b>	<b>1,650,000</b>	

Sipas ekspertës ndryshon numri i kuotave që duhej të ishte sipas statutit të vjetër dhe levizjeve me akte noteriale nga gjendja aktuale e kuotave të regjistruara në QKR për 10/ paditesit. Por kjo është edhe për ortakët e tjere të shoqërisë, të cilëve nuk iu korrespondojnë kuotat dhe vlera e tyre në kapitalin themeltar të shoqërisë, krahasuar me dy statutet, të pasqyruar nga ekspertja në tabela analitike shoqëruese të aktit të ekspertimit.

Po sipas ekspertës Asambleja e ortakëve ka bërë ndryshime të numrit të kuotave pa marrë vendim për të bërë rivleresime, ose duhet të shtonte vlerën e kapitalit themeltar dhe të kuotave në momentin e blerjes së truallit. Ekspertja sqaron se duke shtuar numrin e kuotave nga shtimi i kapitalit, do të arrihej ulja në përqindje e peshës specifike të secilit ortak në totalin e kapitalit themeltar të shoqërisë, por nuk do të ndryshonte numrin e kuotave të regjistruara dhe nuk sillte anomali të tilla, ku ndryshimet e kuotave nuk mund të kenë një bazë krahasimi me statutet që asambleja e ortakëve ka miratuar në të dy rastet. Nuk gjendet asnjë vendim i asamblesë së ortakëve që të ketë kërkuar ndryshim të vlerës nominale të kuotës apo ndryshim të të kuotave nderkohe që ka vendim të asamblesë së ortakëve që ka miratuar kalim të numrit me të vogël të kuotave të ortakëve ndryshe nga sa parashikon statuti. Vetë asambleja e ortakëve nuk ka zbatuar statutin fillestar të shoqërisë sepse në këto vendime nuk është dhënë asnjë shpjegim për çfarë arsye ka ndryshuar numri i kuotave të secili ortak. Pra në pjesët takuese të secilit ortak në përgjithësi dhe për 10/ paditesit në vecanti ka ndryshuar pjesa takuese dhe kjo ka ndodhur jo për shkak të ndryshimit të vlerës nominale të kuotës por për shkak të ndryshimit të numrit të kuotave nga miratimi i statutit të parë të vitit 1995 me statutin e vitit 2012.

**Pretendimet e palëve :** Secili nga 10/paditesit pretendon se ajo çka figuron e regjistruar në regjistrin tregtar nuk pasqyron saktësisht kuotat që ata zotërojnë në shoqëri ku si titull i fitimit

te tyre kane shërbyer kontratat e shitjes me ish/ortakët e shoqërisë, ndërsa për 4/prej tyre akti i themelimit te shoqërisë, ku ata me cilesine e ortakut themelues përkundrejt derdhjes së kontributit, kane fituar cilësinë e ortakut në Shoqëri që me krijimin e saj. Mungesa e kulturës juridike të secilit nga 10/ortakët paditës duke firmosur akte të shoqërisë, deri në firmosjen e staturit te ri të Shoqërisë me gjendjen e ortakërisë së kundërshtuar, pa pasur dijeni se me sa kuota ekuivalente per secilin blerjet e kapitalit te ish/ortakut shitës, ka qenë sipas palës paditëse shkaku që padia për cënim në te drejtat e ortakërisë nuk është ngritur më parë edhe pse nga pala e paditur nuk u ngrit prapësimi për parashkrim të së drejtës së padisë. Për këtë shkak ata kanë kërkuar nga administratori i ri thirrjen e mbledhjes se Asamblesë së Përgjithshme së Shoqërisë me qëllim "rivlerësimin e kuotave të ortakëve paditës si dhe gjithë ortakëve të tjerë të shoqërisë", por asambleja në vendimin e dt. 25.06.2016 ka arritur në vendimmarrjen që për këtë këtë pretendim secili nga 10/ortakët duhej t' i drejtohej Gjykatës. Në këto kushte (gjendja faktike pjese e shkakut te padisë) është ngritur padia objekt gjykimi.

Nga ana tjetër pala e paditur e përfaqësuar nga administratori i ri Edmond Sulo, prapësoi se pas ndryshimit te administratorit ishin konstatuar shume parregullsi ne dokumentacionin qe shoqëria dispononte si dhe në atë të depozituar për regjistrim në regjistrin tregtar, ku shumica e akteve noteriale për transferimin e kuotës se ortakut i referoheshin vlerës se kapitalit që ortaku kishte dhënë si kontribut në shoqëri dhe jo kuotës që ai zotëronte, çka ishte miratuar nga asambleja pa u caktuar një ekspert qe te bënte vlerësimin e kuotës së shitur. Ky fakt kishte sjellë anomali të gjithë gjendjes së kuotave edhe pas pakësimit te kapitalit themeltar, gjendje e cila ishte e pamundur te rregullohej me vendim te Asamblesë pasi ortakët që zotëronin në mënyrë abuzive shumicën e kuotave nuk kishin interes. Për këtë shkak ai kërkoi pranimin e pjesshëm të padisë nëpërmjet anulimit të dy vendimeve të asamblesë së Shoqërisë dt. 10.09.2009 i zbardhur ne dt. 11.09.2009 si dhe atij te dt. 16.11.2009, për shkak se ishin marrë në kundërshtim flagrant me ligjin, por Gjykata nuk mund të rregullonte kryesisht gjendjen e kuotave për 10/ortakët paditës, pasi kjo mund te behej vetëm me vendim të Asamblesë sipas gjendjes se ortakërisë para vendimit te dt. 10.09.2009. E kundërta do te ndryshonte tërësinë e kuotave te shoqërisë.

#### ***Arsyetimi i Gjykatës :***

Shoqëria tregtare si subjekt i së drejtës është një entitet abstrakt e cila krijohet me vërtetimin e fakteve juridike të cilat kanë natyrën e veprimeve juridike, konkretisht Statuti i Shoqërisë, i cili në rastin kur shoqëritë themelohen nga 2 ose me shume persona (fizikë ose juridike), përmban veshjen e vullnetit të tyre për të krijuar pasoja juridike që konsistojnë pikërisht me krijimin e një subjekti të së drejtës si dhe nëpërmjet marrjes së përgjegjësisë së themeluesve, ortake apo aksionarë, në përputhje me kontributin apo pjesëmarrjes në fitime. Në këtë aspekt për të interpretuar dispozita statutore të shoqërive tregtare e që nuk janë të qarta, Gjykata zbaton rregullin e përgjithshëm të interpretimit të kontratave, nëse në Ligjin e Posaçëm Nr.9901, datë 14.04.2008 "Për tregtarët e shoqëritë tregtare", të ndryshuar nuk parashikohet ndryshe.

Në rastin konkret konflikti mes palëve në proces ka lindur pikërisht lidhur me shtrirjen e të drejtave të ortakërisë së 10/ortakëve paditës e thënë ndryshe numrit të kuotave që ata zotërojnë në Shoqëri. Ky konflikt ka lindur për shkak :

1) të Vendimit dt. 10.09.2009 i zbardhur ne dt. 11.09.2009 me ane te te cilit janë miratuar transferime kuotash nga njëri ortak tek tjetri si dhe ;

2) të Vendimit dt. 16.11.2009 me anë të cilit është zvogëluar numri i kuotave dhe kapitali themeltar i Shoqërisë i cili ka prekur ne mënyrë abuzive edhe ortakët që nuk kishin kryer transaksione me kuotat e tyre siç janë paditësit Ardian Mbole, Pllumb Cala dhe Albert Koço.

Për të dy vendimet e mësipërme ortakët paditës kërkojnë që ato të anulohen nga Gjykata si vendime të pavlefshme. Për të shqyrtuar kushtet e kësaj pavlefshmërie të dy vendimeve te asamblesë se Shoqërisë "Transudhëtare" shpk për shkak të të cilëve sipas ekspertes kishte ndryshuar gjendja e ortakerise tek pala e paditur Shoqëria "Transudhëtare" shpk, me diferencat e pasqyruara në tabelat e mësipërme Gjykata mori në analizë dispozitat e Ligjit në fuqi ne kohën e marrjes së këtyre vendimeve, Ligjit Nr. 9901 dt. 14.04.2008 para ndryshimeve që ai ka pësuar me Ligjin Nr. 129/2014, si dhe dispozitat e Statutut të Shoqërisë në pjesën qe nuk bien ne kundërshtim me Ligjin, pasi referuar nenit 231 të Ligjit 9901, dispozitat e këtij ligji zbatohen për procedurat e themelimit ose të ndryshimit të një themeluesi, aksionari apo ortaku të shoqërisë, për procedurat e zgjedhjes së organeve, të miratimit të rregulloreve apo statutit dhe për procedura të tjera organizative, të nisura në çastin e hyrjes në fuqi të ligjit. Aty ku ligji i lejon statutit një rregullim te ndryshëm zbatohet ky i fundit.

Konkretisht Ligji i zbatueshëm në rastin konkret parashikon :

**Neni 68 i Ligjit (pa ndryshime) :** 1. Shoqëria me përgjegjësi të kufizuar është një shoqëri tregtare, e themeluar nga persona fizikë ose juridikë, të cilët nuk përgjigjen për detyrimet e shoqërisë tregtare dhe mbulojnë personalisht humbjet e shoqërisë deri në pjesën e pashlyer të kontributeve të nënshkruara. Kontributet e ortakëve përbëjnë kapitalin e regjistruar të shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar. 2. Secili ortak gëzon kuotën e tij në shoqëri, në përpjesëtim me kontributin që ka dhënë në kapital. Kapitali i regjistruar i shoqërisë ndahet ndërmjet ortakëve në kuota, sipas këtij raporti. 3. Shoqëritë me përgjegjësi të kufizuar nuk mund të ofrojnë kuotat e tyre si mjete investimi për publikun e gjerë. 4. Me përjashtim të rasteve kur ky ligj përcakton ndryshe, marrëdhëniet ndërmjet ortakëve mund të përcaktohen në statutin e shoqërisë. 5. Kontributi i ortakëve mund të jetë në para ose në natyrë (pasuri të luajtshme/të paluajtshme apo të drejta). Statuti përcakton mënyrat e shlyerjes së kontributeve. 6. Ortakët e një shoqërie me përgjegjësi të kufizuar i vlerësojnë kontributet në natyrë në marrëveshje të ndërsjella me njëri-tjetrin dhe i shprehin vlerat e tyre në para. Nëse nuk mund të arrihet një marrëveshje, secili prej ortakëve mund t'i drejtohet gjykatës përkatëse, për të ngarkuar një ekspert vlerësues, me një vendim me efekt detyrues. Raporti i ortakëve ose i ekspertit për vlerësimin e kontributeve i dorëzohet Qendrës Kombëtare të Regjistrimit, së bashku me të dhënat e tjera të kërkuara për regjistrim.

**Neni 73 i Ligjit (pa ndryshime)** parashikon : "1. Kuotat e kapitalit të një shoqërie me përgjegjësi të kufizuar e të drejtat që rrjedhin prej tyre mund të fitohen apo kalohen nëpërmjet: a) kontributit në kapitalin e shoqërisë; b) shitblerjes; c) trashëgimisë; ç) dhurimit; d) çdo mënyrë tjetër të parashikuar me ligj. 2. Në rastin e kalimit të kuotave me kontratë, kontrata duhet të bëhet me shkrim. 3. Statuti mund të kushtëzojë kalimin e kuotave, veçanërisht duke përcaktuar miratimin e shoqërisë ose të drejtën e parablerjes në favor të shoqërisë apo të ortakëve të tjerë.

Në lidhje me parashikimin e mësipërm ligjor ne statutin e Shoqërisë ne fuqi në vitin 2009 parashikohej : "Për tjetërsimin e kuotave te të tretët, ortaku duhet të njoftojë shoqërinë, e cila brenda 3/muajve nga marrja dijëni duhet te jape vendimin për lejimin e transferimit, vendim i cili kërkon unanimitetin e ortakëve".

Referuar parashikimeve të mësipërme ligjore qofte dhe vetëm për shkakun se miratimi i tjetërsimit te kuotave në të dyja vendimet nuk është bere ne unanimitet, këto vendime janë të

pavlefshme sepse bien ne kundërshtim me ligjin. Pavlefshmëria lidhet me natyren juridike te vendimmarrjeve te tilla si veprime juridike, per te cilat zbatohen rastet e pavlefshmerise njelloj si per cdo veprim tjetër juridik sipas parashikimeve te nenit 92 të K.Civil. Me ndryshimin e statutit sot për lejimin e transferimit kërkohet shumica e cilësuar.

Këto vendime janë të pavlefshme edhe sepse Asambleja ka miratuar transferimin total të kuotave nga njëri ortak tek tjetri, pa caktuar një ekspert për të bërë vlerësimin e kapitalit te transferuar si vlerë nga ortaku me qëllim përcaktimin e kuotave te transferuara. **Asambleja ka miratuar transferim total apo te pjesshëm nga një ortak tek disa ortakë ekzistues apo ortakë te rinj, duke kryer miratim tej vullnetit te vete ortakut që ka bere transferimin.** Kjo vendimmarrje vjen në kundërshtim me ligjin dhe përbën shkak për pavlefshmëri të vendimmarrjes së shoqërisë.

**Neni 74 i Ligjit parashikon :** "Personi që kalon kuotën dhe ai që e fiton atë përgjigjen në mënyrë solidare ndaj shoqërisë për detyrimet që rrjedhin nga zotërimi i kuotës, nga çasti i kalimit të kuotave, deri në çastin e regjistrimit të kalimit, sipas pikës 2 të këtij neni. 2. Shoqëria regjistron kalimin e kuotës, sipas nenit 43 të ligjit nr. 9723, datë 3.5.2007 "Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit". Regjistrimi i kalimit të kuotave ka efekt deklarativ".

**Neni 101 i Ligjit parashikon :** " 1. Ortaku mund të largohet nga shoqëria nëse ortakët e tjerë ose shoqëria kanë kryer veprime në dëm të tij, nëse është penguar të ushtrojë të drejtat e tij, nëse shoqëria i ka ngarkuar detyrime të paarsyeshme apo për shkaqe të tjera, që e bëjnë të pamundur vazhdimin e ortakërisë. 2. Ortaku që kërkon largimin, duhet të njoftojë shoqërinë me shkrim, si dhe të parashtojë shkaqet e largimit. 3. Administratorët duhet të thërrasin mbledhjen e asamblesë së përgjithshme menjëherë pasi të kenë marrë dijeni për njoftimin e largimit, sipas pikës 2 të këtij neni, për të vendosur nëse ortakut do t'i likuidohet kuota, si pasojë e largimit për shkaqe të arsyeshme. 4. Ortaku ka të drejtë të ngrejë padi në gjykatë ndaj shoqërisë për likuidimin e kuotës, si pasojë e largimit për shkaqe të arsyeshme, nëse pas njoftimit të largimit asambleja e përgjithshme nuk mblidhet apo nuk ? njeh si të arsyeshme shkaqet e largimit dhe likuidimin e kuotës. 5. Ortaku që kërkon largimin nga shoqëria, detyrohet ta dëmshpërblejë shoqërinë për dëmet e shkaktuara, nëse rezulton se largimi është kryer në bazë të shkaqeve të paarsyeshme. 6. Ortaku që largohet ka të drejtë të ngrejë padi ndaj shoqërisë dhe/ose ortakëve të tjerë që shkaktuan largimin e tij dhe të kërkojë ndaj tyre, në mënyrë solidare, shpërblimin e dëmit të pësuar".

Në rastin objekt gjykimi me vendimin e dt. 16.11.2009 është miratuar largimi i disa ortakëve por nuk është miratuar vlera e likuidimit të kuotës së tyre. Në vazhdim është miratuar në mënyrë abuzive e te kundërligjshme zvogëlimi i kapitalit themeltar si dhe zvogëlimi i kuotave te shoqërisë nga 1349 kuota ne 1325 kuota, i pambështetur ne asnjë akt dorëheqjeje me shkrim.

Të dy vendimet e asamblesë janë të pavlefshëm për shkaqet e analizuara me lart pasi vijne ne kundërshtim me ligjin e posaçëm e dispozitat e statutit qe ka edhe ai fuqinë e ligjit, të pasqyruara në regjistrime të pavlefshme në QKR (sot Qendra Kombëtare e Biznesit). Për pasoje këto regjistrime duhet të fshihen nga regjistri tregtar duke u regjistruar shoqëria në gjendjen e ortakërisë, kuotave e kapitalit themeltar para vendimit të dt. 10.09.2009 i zbardhur në dt. 11.09.2009. I takon Asamblesë së Përgjithshme të Shoqërisë që ne vazhdim të marre vendimmarrjet e duhura pas caktimit te ekspertit kontabël për të miratuar transferimet e kuotave, veprime juridike te mëparshme të kryera nga çdo ortak, pa u prekur nga ky vendim vlefshmëria e këtyre transaksioneve. Prandaj pretendimet e 10/paditësve me përjashtim të paditëses Polikseni Cili, vlerësohen te mbështetura në ligj nga Gjykata. Për paditësen Polikseni Cili nuk ekziston

interesi i ligjshëm në ngritjen e padisë, pasi nga provat e marra në gjykim, nuk rezultoi e provuar që ajo të kishte blere një numër më të madh kuotash në shoqëri se sa ato të regjistruara.

Lidhur me afatin 3/vjeçar të parashkrimit në rastin konkret, ai nuk merret parasysh kryesisht nga Gjykata, në kushtet kur nuk u pretendua nga pala e paditur.

Gjykata vlerëson gjithashtu se pranimi i pretendimit tjetër objekt padie për urdhërimin e kryerjes së ndryshimeve në regjistrin tregtar lidhur me numrin e sakte të kuotave të përcaktuara nga ekspertja për 10/ortakët paditës, do të ndryshonte numrin total të kuotave të Shoqërisë "Transudhëtare" shpk, e drejte kjo që i takon vetëm Asamblesë së Përgjithshme të Shoqërisë, prandaj lidhur me këtë pretendim padia rrëzohet.

Bazuar në analizën e mësipërme ligjore e faktike Gjykata vlerëson se padia është e mbështetur pjesërisht në ligj e prova, prandaj vendos pranimin e pjeshëm të saj duke u rrëzuar pretendimi për kryerjen e ndryshimit të numrit të kuotave vetëm për ortakët paditës.

### PËR KËTO ARSYE

Gjykata mbështetur në nenet 126, 306 e vijues të K.Pr.Civile

### VENDOSI :

1. Pranimin pjesërisht të padisë.
2. Anulimin e vendimeve të Asamblesë së Shoqërisë "Transudhëtare" shpk, dt. 10.09.2009 i zbardhur në dt. 11.09.2009 për miratimin e transferimit të kuotave si dhe vendimit dt. 16.11.2009 për zvogëlimin e kapitalit themeltar dhe numrit të kuotave dhe vendosjen e shoqërisë në gjendjen e ortakërisë, para vendimit të dt. 10.09.2009.
3. Rrëzimin e padisë për pjesën tjetër.
4. Rrëzimin e padisë për paditësen Polikseni Cili.
5. Një kopje e këtij vendimi të regjistrohet pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit.
6. Shpenzimet gjyqësore në ngarkim të palës së paditur.
7. Ndaj këtij vendimi lejohet ankim në Gjykatën e Apelit Vlorë, brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga e nesërmja e shpalljes së vendimit.

*U shpall sot në Lushnje, më 06.09.2016.*

SEKRETARE  
MATILDA CELA

GJYQTARE  
BRIKENA UKPERAJ- LUBONJA

#### *Shpenzime gjyqësore*

Taksë regjistrimi padie -----	3 000 lekë
Shpenzime për njoftime-----	1 800 lekë
Shpenzime për akt ekspertimi	48.000 lekë
<b>Totali</b>	<b>52 800 lekë</b>

Vërtetohet se vendimi ka marrë formë të provës së parë

21/09/2016

Eugen Sylari  
Kancelari